

Shtojca A - Orari operues i sistemit AIPS.

Ora	Ngjarja	Operacionet dhe funksionet e mundshme
08.00	Fillimi i procedurave të ditës	Fillimi i procedurave të hapjes së ditës së punës në AIPS. Fillojnë procedurat për hapjen e ditës së punës dhe zgjasin deri në 08.30.
08.30	Fillimi i operimit	Pjesëmarresit mund të dërgojnë dhe të marrin pagesa.
08.30 - 09.30	Shlyhen në AIPS transaksionet e pagesave me datë valutë ditën e punës, të iniciuara nga sistemet e brendshme të BSH; Shlyhen në AIPS transaksionet e arketimeve të iniciuara nga bankat.	Llogaria kryesore e qeverisë në AIPS/PACS debitohet/kreditohe për veprime të iniciuara në sistemin e brendshëm të Bankës, me kërkesë të vetë Ministrisë, dhe që kanë datë valutë ditën e punës. Bankat derdhin në llogarinë kryesore të qeverisë totalin e të ardhurave të arkëtuara ditën paraardhëse.
09.00 - 10.00	Shlyerja e rezultateve të ankandit të letrave me vlerë	Banka e Shqipërisë hedh në sistem rezultatet e ankandit të letrave me vlerë.
09.00 – 15.30	Shlyhen urdhërpagesat e dërguara në mënyrë elektronike nga Ministria	Sistemi AIPS pranon urdhërpagesa të dërguara në mënyrë elektronike nga Ministria për shlyerje në llogaritë e qeverisë në AIPS/Pacs. Ministria kujdeset për dërgimin e fileve me urdhërpagesa në oraret e rëna paraprakisht dakord (09:30 – 12:00 – 14:00), orare të cilat mund të ndryshohen duke njoftuar pikat e kontaktit. Filet me urdhërpagesa validohen dhe në rast erroresh, sistemi gjeneron listë elektronike për pagesat me error.
10.05- 10.15	Shlyerja neto e rezultatit të seancës së parë të kleringut të sistemit AECH	Sistemi AECH gjeneron instruksionin e shlyerjes neto të seancës së parë të kleringut, e cila dërgohet në AIPS nëpërmjet ndërfaqes AECH-AIPS.
11.00- 11.30	Shlyerja e rezultatit të klerimit të kartave VISA	Banka e Shqipërisë hedh në sistem rezultatin e klerimit të kartave VISA nga ALNNS.
12.35- 12.45	Shlyerja neto e rezultatit të seancës së dytë klering-ut të sistemit AECH	Sistemi AECH gjeneron instruksionin e shlyerjes neto të seancës së dytë të kleringut, e cila dërgohet në AIPS, nëpërmjet ndërfaqes AECH-AIPS.
13.00- 14.00	Shlyerja e rezultatit të klerimit të kartave Mastercard	Banka e Shqipërisë hedh në sistem rezultatin e klerimit të kartave Mastercard nga MCISS.
13.30- 14.00	Shlyerjet neto të kleringut të çeqeve	Banka e Shqipërisë hedh në sistem rezultatet e kleringut të çeqeve.
14.50- 15.00	Shlyerja neto e rezultatit të seancës së tretë klering-ut të sistemit AECH	Sistemi AECH gjeneron instruksionin e shlyerjes neto të seancës së dytë të kleringut, e cila dërgohet në AIPS, nëpërmjet ndërfaqes AECH-AIPS.
15.30	<i>Cut-off</i> fillestar	Sistemi AIPS nuk pranon më pagesa për klientët MT103. Lejohen vetëm pagesa të tipit banke me banke (MT 202). Sistemi AIPS lejon hedhjen e transaksioneve manualisht nga Banka e Shqipërisë. Pjesëmarrësit duhet të marrin masa për sigurimin e fondeve të mjaftueshme për kthimin e ILF së përdorur para <i>cut-off</i> përfundimtar

16.00	<i>Cut-off</i> përfundimtar	<p>Sistemi nuk pranon transaksionet e ardhura me mesazhe SWIFT MT202.</p> <p>Sistemi AIPS nuk lejon hedhjen e transaksioneve manualisht nga Banka e Shqipërisë.</p>
16.30	Mbyllja e sistemit	<p>Kryhen procedurat e mbylljes së sistemit, gjenerohen raportet e fund-ditës, dërgohen gjendjet e llogarive me MT 950.</p>